




REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PRESEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	18-12-2024
NR/BR.	01-371
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës- KOSST-it, ngastrën kadastrale me nr. 103-0 Z.K. Sojevë

Në mbështetje të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, neni 14 paragrafi 1, neni 15 paragrafi 2, neni 16 paragrafi 1, Ligji Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

VENDIM


Për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës-Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A (KOSST)

1. Bartjen në pronësi të Republikës së Kosovës - kompanisë publike Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A (KOSST) me numër unik 811284512, adresë në rrugën "Ilaz Kodra", Prishtinë, ngastrën kadastrale me nr. 103-0 Z.K. Sojevë me sipërfaqe 2.34h, pronë e Komunës së Ferizajt.
2. Qëllimi i bartjes së pronës në emër të Republikës së Kosovës është arritja e interesit publik, ndërtimi e sistemit BESS projekt ky për ruajtjen e energjisë i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës sipas marrëveshjes "Compact", e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Ligjit Nr. 08/L-159.

3. Ngastra kadastrale e përshkruar më lartë barten pa kompensim,
4. Pas miratimit të vendimit nga Kuvendi Komunal, Kuvendi e autorizon kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën me Ministrinë e Ekonomisë dhe KOSST-in.
5. Obligohet Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në operatin kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore.

Propozimit i bashkangjiten:

- *Kërkesa nga Ministria e Ekonomisë*
- *Çertifikata e pronësisë, Kopja e Planit*
- *Skicen e parcelës.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

DATE / A	13.11.2024
PËR / ZA / TO	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
CC:	Florina Duli Sefaj, Kryeshefe Ekzekutive - MCA Kosova Burim Hashani, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv për Programe - MCA-Kosova Bajram Neshati, Drejtor i Projektit BESS - MCA-Kosova Evetar Zeqiri, Kryeshef Ekzekutiv - KOSTT sh.a. Arsim Tahiri, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë
NGA / OD / FROM	Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë për bartjen e pronësisë së pronës publike komunale nga Komuna e Ferizajt te Ndërmarja Publike Qendrore Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT sh.a

I nderuari Kryesues i Kuvendit Komunal z. Zariqi,

I nderuari Kryetar i Komunës z. Aliu,

Fillimisht, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme ndaj Llogarisë së Sfidës së Mijëvjeçarit Kosova ("MCA-Kosova") dhe Programit Kompakt të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit ("MCC") për Kosovën.

Sic jeni të informuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ("SHBA"), duke vepruar përmes MCC dhe Republika e Kosovës (Qeveria), pas diskutimeve të vazhdueshme të sfidave në sektorin e energjisë në Kosovë, përfundimisht në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshjen "Compact" (shih të bashkëngjitur shtojcën nr.1), e cila më pas është ratifikuar si Marrëveshje Ndërkombëtare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Ligjit Nr. 08/L-159. Kjo marrëveshje parasheh investime në vlerë prej rreth 237 milionë dollarë amerikan në Republikën e Kosovës, nga të cilat 202 milionë janë grant nga SHBA dhe 34.7 milionë janë kontribut nga Republika e Kosovës.

Një komponent kyç i kësaj marrëveshjeje është Projekti i Ruajtjes së Energjisë, i cili ka për qëllim kryesor të mbështesë sigurinë energjetike të Republikës së Kosovës dhe të përshpejtojë tranzicionin drejt një të ardhme më të pastër energjetike, përmes përdorimit të sistemeve të

avancuara të ruajtjes së energjisë, duke ulur njëkohësisht koston e energjisë elektrike për vendin tonë. Ky projekt përfshinë tri aktivitete kryesore, ndër të cilat dy konsistojnë në ndërtimin e sistemeve të ruajtjes së energjisë përmes baterive ("BESS") dhe aktiviteti i tretë përqendrohet në mbështetjen e politikave të energjisë dhe klimës në Kosovë.

Duke qenë se ky projekt është i një rëndësie të veçantë për sistemin elektroenergjetik të Kosovës dhe për konsumatorët e energjisë elektrike të vendit, si i tillë, konsiderohet si projekt me interes të veçantë publik.

Aktiviteti i parë i Projektit të Ruajtjes së Energjisë synon të pajisë Operatori e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT), me një sistem BESS me kapacitet prej afërsisht 45 MW (90 MWh), për të zbutur disbalancat në rrjetin elektrik dhe për të mundësuar integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Për të zbatuar këtë projekt, MCA-Kosova dhe KOSTT sh.a. me datë 26 janar, 2024 kanë nënshkruar Marrëveshjen për Zbatimin e Projektit (shih të bashkëngjitur shtojcën nr. 2).

Pas studimeve gjeologjike të lokacionit të përshtatshëm për ndërtimin e sistemit BESS, duke përfshirë aspektet tjera si: ndikimi në komunitet, ndikimi në mjedis dhe konfiguracionin e rrjetit energjetik, Qeveria e Republikës së Kosovës, së bashku me MCC-në, kanë identifikuar një ngastër të përshtatshme në fshatin Sojevë, në afërsi të nënstacionit të KOSTT NS Ferizaj 2 400/110 kV, respektivisht ngastra kadastrale me numër P-72217082-00103-0.

Bazuar në më sipër dhe duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në fuqi nga data 8 dhjetor 2023, (shih të bashkëngjitur shtojcën nr.3) dhe në veçanti në nenin 16, paragrafi 1 i cili përcakton që: "Nëse një pronë e caktuar e cila është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme për realizimin e një interesi publik të Kosovës, njësia e vetëqeverisjes lokale është e obliguar që këtë pronë t'ia bartë shtetit të Kosovës, pa kompensim";

Po ashtu, në nenin 15, paragrafi 2 të këtij Ligji përcaktohet që: "Pas çdo iniciimi për bartjen e pronësisë të pronës publike për sendet e paluajtshme të Njesisë për Vetëqeverisje lokale përmes bartjes për realizimin e interesit publik apo këmbimit, vendos Kuvendi i Komunës në të cilën ndodhet prona".

Duke marrë parasysh që KOSTT sh.a. si Ndërmarrje Publike Qendrore është në pronësi të Republikës së Kosovës dhe me qëllim të thjeshtimit të procedurave administrative, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Pronën Publike të cituara më lartë, kërkojmë që pronësia mbi ngastrën kadastrale me numër P-72217082-00103-0 t'i bartet drejtpërdrejtë KOSTT sh.a.


Prandaj, në përputhje me kompetencat komunale dhe autorizimet ligjore kërkojmë nga ju që:

-Të **MIRATONI** kërkesën për bartjen e pronësisë së pronës publike komunale të parcelës: P-72217082-00103-0; Njësia Kadastrale Ferizaj, Zona Kadastrale Sojevë, me sipërfaqe 2.34 hektarë, nga Komuna e Ferizajt të Ndërmarrja Publike Qendrore Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT sh.a.

Për çfarëdo hollësie të mëtejshme lidhur me këtë kërkesë ju lutem të kontaktoni MCA-Kosova.

Singerisht,

Artane Rizvanolli
Ministre e Ekonomisë





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217082-00103-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	96566/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.12.2024 - 14:57
Komuna / Opština / Municipality:	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Sojevë / Sojevo / Sojevë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72217082-00103-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		23523			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SHAVAR				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 6/Njiva 6 Klase/6th Class Arable Land	23523

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Ferizajit	600629804	/ / /		DËSHMORËT E KOMBIT	1/1		